



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 137/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Blerim Dina-Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “NTP Lulishtja Buçaj” – Graçanicë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “NT Biti Com” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me drunj dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. prokurimi: 616/18/007/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë” më datën 08.05.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NTP “Lulishtja Buçaj” - Graçanicë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me drunj dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. prokurimi: 616/18/007/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë”

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së /KK-Prishtinë/ lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizimi me drunj dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. prokurimi: 616/18/007/111 dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NTP “Lulishtja Buçaj” - Graçanicë aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 30.01.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 07.03.2018

Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoritet Kontraktues, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt: 27.03.2018, ku është rekomanduar për kontratë OE- NT”Biti Com”- Podujevë

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik NTP “Lulishtja Buçaj”-Graçanicë me dt: 30.03.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 04.04.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE NTP “Lulishtja Buçaj” - Graçanicë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues NTP “Lulishtja Buçaj” – Graçanicë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.04.2018 me nr. 137 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me drunj dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. prokurimi: 616/18/007/111 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "KK-Prishtinë" duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59, 60, 69 dhe 70 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.04.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 27.04.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues NTP "Lulishtja Buçaj" - Graçanicë se ka pasur shkelje të LPP gjegjësisht nenit 6, 7, 59, 60, 69 dhe 70 në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, sa i përket Certifikatës Fito Sanitare ku në FDT është kërkuar të dëshmohet Certifikata Fito sanitare, Eksperti profesional bazuar në kërkesën e lartcekur vlerëson se OE ankues nuk ka të drejtë në pretendimin ankimor për faktin se OE i rekomanduar për kontratë nga AK, ka ofruar certifikatën fito-sanitare nga Holanda (të datës 27/02/2018) për produktet e kërkuar e në aneksin 1 të dosjes së tenderit, për faktin se OE i rekomanduar për kontratë certifikatën të cilën e ka ofruar si e tillë e plotëson kërkesën e AK-së.

Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të dëshmojë në lidhje me certifikatën e origjinës së mallit dhe dudi doganor i cili kërkohet për drunjtë dekorativ, eksperti profesional vlerëson se ky pretendim nuk qëndron për faktin se këto dy dokumente nuk kanë qenë kërkesë në FDT por autoriteti kontraktues këto dy dëshmi është i obliguar ti kërkojë gjatë fazës së furnizimit përkatësisht gjatë implementimit të kontratës me OE.

Eksperti profesional duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pa bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin Nr.1), dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së KK Prishtinë.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.04.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.04.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.05.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi i OE ankues, Autoriteti Kontraktues, dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Buçaj deklaroj: Çështja kryesore është te dokumentet sanitare që kanë kërkuar KK Prishtinë. Kur kemi konkurruar është kërkuar certifikata sanitare e prejardhjes së mallit nga BE. Kur kemi pas qasje në dokumente pranë AK-së pasi është shpall fituesi, kemi pa se sanitaret nuk janë në përputhje me kërkesat në Paramasë të dosjes. Në qasje kemi pa një certifikatë fito sanitare e cila është për dhe (substrat), dhe nuk ka treguar prejardhjen se drunjtë janë me prejardhje nga BE. Kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që siç ceka që certifikata sanitare të jetë me prejardhje nga BE. Njëtin problem kemi pas edhe me KK Fushë Kosovë, dhe në fund malli ka ardhur nga Serbia dhe Shqipëria dhe deri më sot nuk i janë kryer pagesat OE në fjalë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z.Mekolli deklaroj: AK KK Prishtinë mbështet plotësisht mendimin e ekspertit lidhur me vazhdimin e aktivitetit për këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimet e OE ankues janë të pabaza për arsye se OE i propozuar për kontratë i ka plotësuar gjitha kërkesat e kërkuara me njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit andaj edhe komisioni ka kryer punën gjithnjë duke u mbështet me LPP dhe UOPP. Certifikatat fito sanitare të dorëzuara nga OE fitues është certifikatë valide e dorëzuar sipas kërkesave në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit dhe plotëson kërkesat e AK. Ndërsa certifikatat tjera, dudat doganor tjerë, OE i takon ti sjell së bashku me furnizimet e bëra, që do thotë për secilin dru do sjell certifikatën e artikullit.

Andaj si AK kemi menduar se ky OE është i përgjegjshëm pasi ka plotësuar gjitha kërkesat e dosjes dhe ka dhënë çmim më të lirë, andaj është rekomanduar për dhënie të kontratës.

Certifikata e kërkuar në dosje shënon “certifikatë fito sanitare për fuqizimet e bëra”, dhe OE fitues e ka certifikatën në fjalë të lëshuar nga Holanda që është vend i BE dhe si e tillë plotëson kërkesat e AK.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Tafa deklaroj: Mendoj se pretendimi i OE ankues nuk qëndron për faktin se certifikata fito sanitare nga Holanda në pikën 10 tregon se kjo certifikatë është konform natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE z.Buçaj deklaroj: Qëndrojmë pranë ankesës dhe i propozojmë panelit shqyrtues që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK z.Mekolli deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se është kërkuar certifikata sanitare e prejardhjes së mallit nga BE, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatë fito sanitare e cila është për dhe (substrat), dhe nuk ka treguar prejardhjen se drunjtë janë me prejardhje nga BE, ndërsa ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me furnizim me drunj dekorativ e jo furnizim me dhe.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit ti përmbahet në detaje kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, dhe ti zbatojë në tërësi dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesues i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "KK-Prishtinë"

1x1 OE -NTP "Lulishtja Buçaj" - Graçanicë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.